



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.102/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja për Bashkim (LB), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në hapësirë publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 03.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.102/2017, e datës 29.09.2017, ndërsa subjektit politik Lëvizja për Bashkim (LB), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 250.00 (dyqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 29.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se me datën 29.09.2017, në lagjen Prishtina e Re, prapa Grand Stores, në Prishtinë, në trafo stacionin elektrik është vendosur poster i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga radhët e subjektit politik Lëvizja për Bashkim.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 pika b), të LPZ-së, të dispozitës së nenit 4.1 pikës b të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Me propozim për panelin që të merren masa ndëshkuese ndaj subjektit politik LB.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 02.10.2017, subjekti politik Lëvizja për Bashkim, ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë, duke theksuar se menjëherë pasi që kemi pranuar kërkesën për përgjigje në urdhër, kemi marr masat përmirësuese ndaj një posterit të kandidatit tonë për asamble komunale të Prishtinës, i cili ishte i vendosur në një trafo stacion duke theksuar se ka evituar shkeljen e pretenduar në ankesë.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur fotografit me të cilat shihet se është larguar posterit nga vendi ku ka qenë i vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të subjektit politik LB, është vendosur në hapësirë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapësira apo në rrugë publike*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteri për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë nga subjekti politik LB, është vendosur në objektin publike përkatësisht në Trafo stacion. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vet subjekti politik LB në përgjigjen në ankesë të datës 02.10.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja për Bashkim, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara, që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti posteri për anëtar të kuvendit komunal të këtij subjekti politik është vendosur në hapësirë dhe në rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin nga vendi i palejuar ku ka qenë i vendosur, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.102/2017 më datën 03.10.2017.

Kryesuesi i Panelit

Hasan Shala



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*